



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 233, Datë 30.09.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 190, DATË 21.07.2022,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NTSP” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN BITINCKË, BILISHT, QARKU KORÇË, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.09.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “NTSP” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 190, datë 21.07.2022, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “NTSP” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.
- Në vendimin nr. 190/2022, në pikën 2 është përcaktuar se: “Shoqëria ‘NTSP’ sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE, jo më vonë se data 11.09.2038, kontratën e qirasë për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuar, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë.”
- Gjithashtu, pika 3 e vendimit parashikon se: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.”

2. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 220, datë 01.09.2022, në Rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar gërmën “g” të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim

shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asetet për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, detyrimi i përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 190/2022 nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator dhe duhet të shfuqizohet.
- Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.
- Për pasojë, duke qenë se pika 3 lidhet drejtpërdrejt me objektin e pikës 2, ajo gjithashtu humbet qëllimin e saj dhe duhet të shfuqizohet.
- Në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizimi i pikave 2 dhe 3 është i domosdoshëm për të harmonizuar vendimin me kuadrin ligjor dhe rregullator të përditësuar, duke garantuar qartësi dhe siguri juridike për shoqërinë “NTSP” sh.p.k.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Ndryshimi është i nevojshëm për të shmangur pasiguritë ligjore dhe për të siguruar koherencë të vendimit me kuadrin rregullator aktual.
- Shfuqizimi i pikave 2 dhe 3 është i domosdoshëm pasi detyrimi i parashikuar në të nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator dhe nuk përbën më një kusht të vlefshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190, datë 21.07.2022, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “NTSP” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI